

Rumania dhe Moldavia Kërkojnë Afrimin

Author: [Marian Chiriac](#)

Një marrëveshje e nënshkruar ndërmjet dy fqinjëve të tensionuar mund të ndihmojë përpjekjet e tyre për integrim në BE.

Lajmi ka qenë një surprizë. Pas shtatë vjet bisedimesh ministrat e jashtëm të Rumanisë dhe Moldavisë fqinje muajin e kaluar kanë arritur më në fund një marrëveshje ndërmjet vendeve të tyre.

Ministri i jashtëm rumun Petre Roman, i entuziazmuar nga pakti i ri, ka thënë se ai do të ndihmojë në stabilitetin europian. Por optimizmi i tij ka qenë në kontrast me mendimin e përhapur gjerësisht se ai vendim nuk ka bërë asgjë për të zgjidhur mosmarrëveshjet e vjetra të të dy vendeve.

Moldavia dhe Rumania kanë pasur prej kohësh një marrëdhënie të ngatërruar. Përpara paktit Molotov-Ribentrop të vitit 1939 dhe aneksimit nga Bashkimi Sovjetik, Moldavia, një zonë e njohur si Besarabia dhe Bukovina veriore - ka qenë pjesë e Rumanisë. Shumë moldavë flasin një gjuhë pothuajse identike me rumanishten, megjithëse pas një referendumi ajo është përcaktuar në kushtetutë si "moldavishte".

Gjatë gjithë bisedimeve të fundit diplomatët rumunë kanë insistuar se marrëveshja hedh poshtë Paktin Molotov-Ribentrop dhe pranon ndarjen e paligjshme të Moldavisë nga shteti rumun. Moldavët e kanë kundërshtuar këtë nga frika se mund të bënte të paligjshme edhe deklaratën e tyre për pavarësi nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1991. Nuk është për t'u habitur që çështja është theksuar shumë në marrëveshje.

I njëjti ekzagjerim politik është i qartë edhe në përshkrimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve në traktat si të "privileguara". Bukureshti kishte kërkuar për një traktat "vëllazërimi" dhe i referohej "dy shteteve rumune," të cilat nuk janë pranuar nga Kishinevi.

Edhe problemi i gjuhës mbetet i pazgjidhur. Bisedimet e zgjatura kanë qenë rreth çështjes se në cilën gjuhë do të shkruhej traktati. Traktati është përgatitur natyrisht në rumanisht, por Moldavia ka insistuar që të përdorej edhe gjuha e saj.

Disa çështje delikate si mosmarrëveshjet për kufirin do të zgjidhen më vonë, megjithëse "principi i mosndryshimit të kufinjve" është vendosur në traktat. Burimet rumune thonë se kjo nuk e përjashton ndryshimin e kufinjve "pra, bashkimin", sepse, sipas një njoftimi të Radios Europa e Lirë, "Akti Final i Helsinkit thotë se ndryshimi paqësor i kufijve - me pëlqimin e të dy palëve - është i mundur."

Pavarësisht nga problemet, të dy ministrat e jashtëm kanë deklaruar se traktati ishte një sukses. "Ky është një zyrtarizim i marrëdhënieve të veçanta ndërmjet dy vendeve," thotë ministri i jashtëm moldav, Nikolae Tabacaru. Roman ka siguruar moldavët për përkrahjen e Rumanisë në përpjekjet e tyre ndërkombëtare për "sigurimin e sovranitetit dhe integritetit territorial."

Traktati duhet të ratifikohet tani nga presidentët e Moldavisë dhe Rumanisë dhe parlamentet e tyre. Pritet që ai të dënohet nga partitë e opozitës, veçanërisht nga ato nacionaliste. Shumë e konsiderojnë atë si një kompromis që nuk zgjidh asgjë. Në fakt ka mundësi që traktati të jetë një hap pozitiv për të dy vendet në përpjekjet e tyre për anëtarësim në BE.

Rumania i shton ambicjet e saj për anëtarësim në BE duke shprehur gatishmërinë e saj për të zgjidhur problemet me fqinjët. Edhe Moldavia duhet të përfitojë në përpjekjet e saj për të arritur statusin e asociimit

në BE dhe për t'u përfshirë më shumë në Paktin e Stabilitetit për Ballkanin Juglindor.

Traktati vjen në një moment kur, pavarësisht nga lidhjet e forta ekonomike dhe kulturore, marrëdhëniet ndërmjet Moldavisë dhe Rumanisë janë diçka ndërmjet miqësisë dhe armiqësisë. Marrëveshja e tyre përfaqëson një pranim nga të dyja palët se afrimi mund të arrihet në kontekstin e integritit më të gjerë europian.

Marian Kiriak është bashkëpunëtor i rregullt i IWPR-së.

Source URL: <https://iwpr.net/sq/global-voices/rumania-dhe-moldavia-k%C3%ABrkojn%C3%AB-afrimin>